

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

7.09.2023

Ora 12:07

RENDI I DITËS

**"Për rishqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023 të depozituar nga
partia politike "Partia Demokratike e Shqipërisë".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. E. Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj, z. M. Bardhi.
- **Parti Politike:** PD (z. I. Sefa)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Lako: Mirë, e riçelim edhe njëherë seancën mbi çështjen ankimore nr. 93, dt. 20.08.2023, të depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë. Kjo çështje u shty në mënyrë që nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të na vihej në dispozicion një informacion në lidhje me ndarjen e mandateve në momentin e kostituimit për këshillat bashkiak sipas forcave politike që i përbëjnë këto këshilla dhe për të qenë më të qartë për çështjen objekt konflikti ndërmjet Partisë së Lirisë dhe mandateve që ka marrë Koalicioni "Bashkë Fitojmë" në lidhje dhe me këtë subjekt. Nga ana e administratës na ka ardhur një listë që është dorëzuar sot, besoj se dhe për palën ankuese... E keni marrë një kopje?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Na është vënë në dispozicion.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. E. Lako: Atëherë shkurtimisht nga administrata, dy fjalë, pavarësisht se kjo ka ardhur me legjendë sqaruese, por dy fjalë në lidhje me si ka ardhur ky informacion dhe na e shpjegoni pak a shumë se cilat janë të dhënat që kanë dalë si rezultat i kërkesës që ju bëri KAS-i drejtuar administratës. Nëse pala ankuese ka ndonjë pyetje apo do të sqarojë diçka është e lirë ta bëjë këtë. Faleminderit, fjala për ju zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Duke qenë se gjatë seancës së KAS-it, gjatë shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 93 na u la si detyrë të komunikojmë me kryetarët ose me sekretarët e këshillave bashkiakë, Administrata e KQZ-së ka komunikuar me të gjithë kryetarët e sekretarët, diku me kryetarin e diku me sekretarin dhe kemi marrë në rrugë telefonike informacionin që j'ua kemi vënë përpara, ku në 53 bashkitë anëtarë të këshillit kanë deklaruar përkatësinë partiake në mbledhjen e parë ndërsa në 8 bashki: Bashkia Klos, Bashkia Shijak, Bashkia Gramsh, Bashkia Divjakë, Bashkia Roskovec, Bashkia Pucetec, Bashkia Himarë dhe Bashkia Sarandë nuk e kanë dhënë përkatësinë partiake pasi anëtarët e këshillit bashkiak kanë deklaruar që jemi anëtarë të Koaicionit “Bashkë Fitojmë”. Nga informacioni për 53 bashkitë janë 113 anëtarë të këshillit bashkiak që kanë deklaruar si përfaqësues të Partisë së Lirisë në këshillat bashkiakë të tyre përkatës. Për 8 bashkitë e tjera nuk kemi informacion dhe nuk i kemi futur në llogaritje.

Z. E. Lako: Pra, mesa e kuptova nga shpjegimi që keni bërë, ky është një informacion i ardhur në rrugë telefonike, pra jo me shkresë, jo zyrtare dhe në 53 bashki figurojnë rreth 113 këshilltarë të subjektit Partia e Lirisë, ndërsa si koalicion nuk keni të dhëna për këto 53 bashki apo jo? Në këtë informacion, si Koalicion “Bashkë Fitojmë” nuk keni të dhëna në këtë tabelë që na keni dorëzuar?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. Y. Merkaç: Për 8 bashkitë e tjera nuk kemi të dhëna.

Z. E. Lako: Po, ndërsa për 8 bashkitë e tjera nuk kemi të dhëna për subjektin Partia e Lirisë, por si koalicion. Pra, kjo është një shifër që flet për 53 bashki dhe në këto 53 bashki si koalicion nuk ka të dhëna, si koalicion sa mandate kanë? Kanë vetëm si Parti e Lirisë. Mirë faleminderit, ka ndonjë pyetje nga kolegët? S'ka! Nga zoti Sefa ka ndonjë koment, pyetje, ndonjë shpjegim?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo komenti... Mjafton që këshilltarët bashkiakë janë të deklaruar si Parti e Lirisë dhe mandatin e kanë marrë si anëtarë të Partisë së Lirisë dhe sipas tyre ne kërkojmë të bëhet dhe përllogaritja e votave të fituara nga Partia e Lirisë si subjekt zgjedhor. Gjithashtu një pyetje kisha për administratën. Doja të dija që informacionin e kërkuar, e keni kërkuar... megjithse në rrugë telefonike, por zyrtarisht dmth personat që e kanë dhënë kanë folur zyrtarisht, kanë kthyer përgjigje zyrtarisht për përkatësinë politike të anëtarëve të këshillit bashkiak?

Z. Y. Merkaç: Tani, komunikimi ka qenë në telefon dhe përgjigja ka qenë në telefon. Me çfarë kanë mbajtur mend, kanë shkuar në zyrë, i kanë parë... Tani unë nuk mund të quhem 100% i saktë megjithatë diku është përgjigjur ktyetari, diku është përgjigjur sekretari. Se sa i saktë është unë nuk mund të jap... I kemi regjistruar telefonatat.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Dmth kanë qenë në të gjitha rastet ose kryetari i këshillit, ose sekretari i këshillit.

Z. Y. Merkaç: Po.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Faleminderit, nuk kam më asnjë pyetje.

Z. E. Lako: Po zoti Braho.

Z. L. Braho: Kam unë një pyetje për zotin Sefa. Tani ju zoti Sefa do t'i qëndroni atij pjestimit me 3 apo do t'i qëndroni numrit të këshilltarëve të PL-së për efekt argumenti në lidhje me kërkesën tuaj? Kur u depozitua ishte pjesëtim për tre, tani thoni që ka 113 këshilltarë duke u bazuar tek informacioni që ka sjellë administrata.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Unë si avokat besoj që nuk rrezikoj dhe i marr të gjitha alternativat. KAS-i të pranojë kë të dojë, ose ta pjesëtojë me tre, ose ta bëjë sipas numrit të mandateve. Duke qenë se ne kemi numrin e mandateve tani, mendoj që do të ishte një alternativë shumë e mirë dhe sipas Kodit Zgjedhor, nenit 67 dhe 88 që është alternativa më e ngjashme, siç e ka konstatuar në të gjitha rastet e mëparshme. Unë nuk e kisha këtë informacion, prandaj mendova që ajo ishte alternativë. Megjithatë nëse KAS-i mendon që ajo mund të jetë një alternativë për të pranuar ankimin e Partisë Demokratike, nuk do të kemi ankesë dhe nuk do ta çojmë në Kolegj Zgjedhor nëse do ta pjesëtoni me 3.

Z. E. Lako: Pra ju e lini në çmim të KAS-it, si ta vendosi KAS-i.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ose njërën ose tjetrën.

Z. E. Lako: Kemi ndonjë pyetje tjetër? Mirë, i japim fund shqyrtimit administrativ. Konkluzionet u thanë shkurtimisht në seancën e kaluar por mund t'i përsërisim meqenëse e riçelëm. Ju e thatë që i qëndroni kërkesave që keni bërë dhe administrata

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

të njejtin qëndrim ka mbajtur. Atëherë do të tërhiqemi për 5 deri në 10 minuta dhe do të mblidhemi përsëri për të shpallur vendimin, Faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 12:22

Z. E. Lako: KAS pasi shqyrtoi dhe administroi gjithë provat e paraqitura me shumicë votash vendosi:

- Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 93 të dt. 20.08.2023, të depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë.


- Lënien në fuqi të vendimit nr. 722, dt. 19.08.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin dhe sekretarin e Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11 për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023”.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

- Bazuar në pikën 1 të nenit nr. 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 152 të Kodit Zgjedhor. Me kaq e deklarojmë të mbyllur këtë çështje, faleminderit!

Vendimi nr. 181

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

07.09.2023

Ora, 12:24

RENDI I DITËS

“Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 94 me objekt “Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 745, datë 04.09.2023 dhe ndryshimin e vendimit duke vendosur, regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, znj. I. Osmanaj, z. M. Bardhi
- **Parti Politike:** PDSH (z. I. Sefa), PD (z. F. Nuri)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Fillojmë seancën e radhës që i përket shqyrtimit në themel të Kërkesës Ankimore nr. 94, të paraqitur nga subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt ankimi “Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 745, datë 4.09.2023 dhe ndryshimin e vendimit duke vendosur, regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”. Në seancën paraprake të zhvilluar dje u komunikua që kemi edhe një kërkesë, pra u pranua edhe kërkesa për ndërhyrje kryesore e Partisë Demokratike me kryetar zotin Lulëzim Basha. Përpara se të fillojmë verifikojmë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

prezencën. Është prezent trupa e plotë e KAS-it. Kjo seancë kryesohet nga unë, anëtari Elvis Çefa. Është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij, është prezent përfaqësuesi i palës ankuese, zoti:

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Franci Nuri prezent.

Z. E. Çefa: Është prezent gjithashtu edhe përfaqësuesi i palës së interesuar.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Indrit Sefa, prezent.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Kërkesa paraprake keni?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Jo.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kam unë një kërkesë.

Z. E. Çefa: Po zoti Sefa.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kam një kërkesë për mënyrën e përfaqësimit të zotit Nuri nga subjekti imagjinar, individi, a ka prokurë, autorizim, çfarë ka?

Z. E. Çefa: Kjo i përket themelit. Këtë fazë ne e kaluan dje. Përderisa ne e legjitimiam dhe pranuan të zhvillojmë këtë seancë, kjo është diçka e gjykuar nga KAS.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo jo...

Z. E. Çefa: Sepse legjitimimi është ABC-ja e procesit.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Të lutem aktin e përfaqësimit të përfaqësuesit të kërkuesit mund të kërkojë pala në çdo moment. Ju lutem më vini në dispozicion aktin e përfaqësimit të përfaqësuesit të kërkuesit.


Z. E. Çefa: Atëherë zoti Nuri, çfarë akti përfaqësimi keni depozituar në KQZ ju lutem, citojeni pak?

Z. F. Nuri: Po, faleminderit i nderuar! Në kërkesën tonë të paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sikundër kemi parashtruar edhe herën e kaluar, pra në mars të 2023-shit janë ekzaktësisht të njëjtat dokumente dhe të njëjtët formularë. Është formulari standart i aplikimit sëbashku me nënshkrimin e kryetarit të partisë, zotit Berisha. Aty figuron edhe emri im, i cili mund të mbajë marrëdhëniet, le të themi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndër të tjera. Jemi dy faktikisht, dy individë, dy avokatë që mund të përfaqësojnë...

Z. E. Çefa: Qartë, ju lutem mund t'ia vendosni në dispozicion kolegut?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Një kopje duhet të jetë te praktika e KQZ-së. Unë nuk e disponoj për momentin një kopje të dokumentacionit të dorëzuar. Fizikisht duhet të jetë te dosja patjetër.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. E. Çefa: Administrata për sa minuta na duhet një kopje, mund ta bëjmë një kopje të saj për avokatin?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Cila është partia politike, ju lutem dhe si vërtetohet që është parti politike?

Z. E. Çefa: Tani ju po shmangni problemin.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Nuk po shmang...

Z. E. Çefa: Ja të mbaroj unë, zoti Sefa të lutem.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në debat ligjor, ju lutem vjen një person dhe i thotë KAS-it, unë jam përfaqësuesi i Partisë Republikane Amerikane dhe dua të regjistrohem në Kukës. Përfaqësuesi im që kam shkruar te kjo letra është filani.

Z. E. Çefa: Këtë po gjykojmë ne pra, ky është thelbi. Ky është themeli, zoti avokat! Për këtë jemi mbledhur këtu.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Dje thatë që e ka bërë si individ apo jo?

Z. E. Çefa: Jo nuk thamë këtë.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Sali Berisha del aty te vendimi i Komisionerit...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. E. Çefa: Edhe njëherë të lutem shumë! Jeni gabim në këtë kërkesë, sepse kjo i përket shqyrtimit të këtij themeli, për këtë punë jemi mbledhur sot. Nëse zotëria do të konsiderohet nga ne parti politike, do të regjistrohet edhe ai në zgjedhje si parti politike, në rast të kundërt nuk do të regjistrohet. Për çdo rast argumentin do e kesh në vendim. Ne për këtë po diskutojmë apo jo? Sepse mund të vijë edhe një person “x” nga rruga e të thotë “dua të regjistrohem në zgjedhje, përfaqëson Franci Nuri”. Ja shqyrton Komisioneri, ja rrëzon kërkesën, a e ka të drejtën të vijë në KAS ai zotëria?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në KAS?

Z. E. Çefa: Po, patjetër! Për sa kohë Komisioneri të pranon një proces administrativ... Atëherë që ta bëjmë më të thjeshtë. Për sa kohë Komisioneri Shtetëror të pranon në një procedim administrativ...


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Është i mbyllur...

Z. E. Çefa: ... pavarësisht pozitës tënde juridike në këtë procedim, ti ke të drejtën e ankimit në KAS. Në të njëjtën pozitë është zoti Nuri sot.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ky organ mbajti qëndrim të kundërt para dy javësh apo jo?

Z. E. Çefa: Jo nuk ka qenë ashtu. Nuk e ke lexuar me vëmendje.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. L. Braho: Tani ju pretendoni që Franci Nuri nuk përfaqëson Sali Berishën, apo që Sali Berisha nuk është subjekt? Sepse që ai u legjitimua u vendos dje.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Aktin e përfaqësimit kërkova unë!

Z. L. Braho: Duhet ta kishe kërkuar dje se sot nuk ke çfarë kërkon më.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në rregull, por mund të kërkohet në çdo kohë.

Z. E. Çefa: Ne e porositëm administratën t’jua verë në dispozicion. Tani kërkesa të tjera paraprake? Unë e kisha fjalën kundrejt trupit gjykues, mos ndoshta doni të përjashtoni ndonjërin nga ne. Jo nuk keni! Atëherë fillojmë normalisht sipas procedurës. I jap fjalën fillimisht zotit Nuri, i cili përfaqëson ankimuesin në këtë procedim administrativ. Fjala është për ju fillimisht zoti Nuri!

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Faleminderit i nderuar! Sikundër dhe e diskutuam pak dje në lidhje me legjitimimin dhe çekëm pak çështjen e thelbit. Ideja është që ne po ripërsërisim të njejtën kërkesë që e kemi depozituar me fjalë të tjera edhe në mars të vitit 2023, duke pretenduar se Partia Demokratike e drejtuar nga zoti Sali Berisha duhet të regjistrohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Duhet të regjistrohet për këto zgjedhje, për zgjedhjet e Kukësit, të 24 shtatorit 2023, sepse ne pretendojmë se Kuvendi Kombëtar i dhjetorit 2021 ka marrë ato vendime që ka marrë dhe ka shkarkuar organet drejtuese të asaj kohe, pa i hyrë historikut. Pastaj më pas ka ndodhur vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës, të 25 marsit të vitit 2022, vendimi Zhukri, në mos gaboj dhe më pas ka ndodhur dhe zgjedhja e kryetarit të ri,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

zotit Berisha nëpërmjet referendumit të mbi dyzet e pesë mijë anëtarëve të Partisë Demokratike. Kjo është dhe në vijim pastaj nuk diskutohet që ka patur dhe evoluime të tjera. Çfarë ka ndodhur ndryshe, çfarë kemi ndryshe dmth, nga hera e kaluar? Kur të gjithë e dimë që KAS-i nuk e pranoi kërkesën tonë dhe Kolegji Zgjedhor po ashtu e refuzoi kërkesën tonë për tu regjistruar. Duke legjitimuar dhe duke pranuar të regjistrojë në zgjedhjet e majit 2023 subjektin e Partisë Demokratike jo me kryetarin, i cili figuronte në regjistrin e partive politike, zotin Basha, por me nënkryetarin në atë kohë zotin Alibeaj, emri i të cilit u pasqyrua edhe në fletën e zgjedhjeve. Çfarë ka ndryshuar tani? Është një pyetje e drejtë. Kemi të bëjmë me disa momente. E para kemi të bëjmë me një dorëheqje publike të zotit Alibeaj sipas shkresave zyrtare të Partisë Demokratike që janë depozituar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe ne e kemi bërë pjesë të praktikës. Pra, ekzistojnë dy elemente. Së pari, bëhet fjalë për një procesverbal të mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike, të datës 27.07.2023, ku pranohet dorëheqja publike e nënkryetarit. Ku këshilli kombëtar i mbledhur rregullisht ka konstatuar se nuk ka nënkryetarë të tjerë për shkak se sikundër dhe kolegu im Sefa e ka thënë në seancat e kaluara që dy nënkryetarët e tjerë të partisë nuk kanë pranuar ta marrin detyrën, përkatësisht zonja Tabaku dhe zoti Gjekmarkaj. Në këto kushte këshilli kombëtar ka konstatuar se partia ka ngelur pa kryetar po e po, se kishte dhënë dorëheqjen, por dhe pa nënkryetar se kujt mund t'i delegohej detyra, sikundër ndodhi edhe në zgjedhjet e fundit. Kështu që në këto kushte këshilli kombëtar ndër të tjera ka zhbërë gjithë ato vendimmarrje që janë marrë në lidhje me organizimin e zgjedhjeve po themi të pjesës që përfaqëson zotin Sefa, nëse më lejoni të shprehem kështu, pra të zotit Basha. I është drejtuar gjykatës që të mos njohë procesin e ashtuquajtur të vendimmarrjes, ose procesin e ashtuquajtur të zgjedhjeve të zotit Basha që pretendon se ka ndodhur përpara disa

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

javësh. Për këtë i është drejtuar gjykatës me shkresë ku kërkon bllokimin e çdo lloj aktiviteti dhe deri më mos gaboj... më lini t'i referohem shkresës, për të qenë më i saktë. Kemi një përgjigje zyrtare të dt. 30.08.2023 nga Gjykata e Tiranës drejtuar zotit Bardhi ku Gjykata e Tiranës shprehet: “Në përgjigje të shkresës suaj të datës 24.08.2023, me anë të së cilës kërkon ekstraktin historik për Partinë Demokratike...” Janë dhënë të gjitha regjistrimet e fundit dhe në fund figuron se ka të regjistruar në ekstraktin e partive politike, Partinë Demokratike, vetëm vendimin e marsit 2022 dhe më pas vendimin e apelit të 3 marsit 2023. Nuk ka të regjistruar asnjë akt tjetër. Pra, shkurtimisht që dhe publiku ta kuptojë sepse është në çështje mjaft teknike dhe ndoshta nuk është e lehtë as për juristët që ta kuptojnë. Problemi që ne ngrejmë është që zoti Basha ka dhënë dorëheqjen publike. Kjo dorëheqje e zotit Basha është pranuar edhe në Kolegjin Zgjedhor dhe partia që pretendon që të regjistrohet nga zotin Basha sot nuk ka kryetar. Nënkryetarët përkatës ose janë shkarkuar ose janë dorëhequr dhe nuk ka se kush ta përfaqësojë këtë subjekt, i cili pretendon se... të cilin Komisioneri e legjitimoi dhe e regjistroi përpara pak ditësh. Ky grupim pretendon se ka kryer zgjedhje të cilat po ashtu janë kontestuar nga sekretari i përgjithshëm i atij grupimi dhe më tej në Regjistrin e Partive Politike nuk kemi më asnjë regjistrim të ri, të rizgjedhjes së pretenduar të zotit Basha. Pra, jemi në një situatë të tillë që nga njëra anë përpara 6 muajsh u detyrua Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ta regjistrojë PD-në me nënkryetarin e komanduar, ndërkohë që sot as ky nënkryetar nuk ushtron më funksionet. Pra, partia nuk ka më një drejtues, të paktën ajo parti që pretendon dhe që është e regjistruar nga vendimi i Komisionerit të cilin ne po e kundërshtojmë sot. Ky është thelbi i të gjithë konfliktit. Ne mendojmë se, pikë së pari duhet të regjistrohet Partia Demokratike me kryetar zotin Berisha për të gjitha arsyet që kemi parashtruar dhe për të gjitha dokumentet që kemi

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

bashkëngjitur, sepse është i vetmi legjitim dhe i mandatuar drejtpërdrejtë nga dyzet e pesë mijë anëtarë me referendum direkt. Pavarësisht se..., është e vërtetë që Gjykata e Tiranës nuk e reflekton këtë në regjistrin e partive politike, sepse ai regjistër nuk është i përditësuar. Sikundër po të ishte i përditësuar edhe me emrin e zotit Basha, pra po të ishte e saktë dhe emri i zotit Basha, nuk e kuptoj se pse nuk u regjistrua me emrin e tij fleta e votimit, le të themi! Nuk u regjistrua partia me kryetar zotin Basha përpara 6 muajsh, por me nënkryetarin. Sot jemi në po të njëjtat kushte. Zoti Basha mund të figurojë aty por është fakt i njohur publik se nuk është ende kryetar ose nuk njihet si kryetar. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Po zoti Sefa e keni ju flalën, apo kishit pyetje?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kam pyetje. Mbani përgjegjësi ligjore personale për të dhënat që referuat aty që janë të sakta? Ka depozitur një shkresë e cila gënjen. Zoti Enkelejd Alibeaj...


Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Gënjen shkresa zotëri.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Mban përgjegjësi pra... Të referojë shkresën...

Z. I Rusmali: (Pa mikrofon, nuk dëgjohet)

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ku shtetëror... Atë tjetrën... janë rrethana të vërteta këto?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Zotëri janë të vërteta apo jo këtë e gjykojnë të tjerët, nuk e gjykoj as unë as ju.


Z. E. Çefa: Ju lutem, do ta keni mundësinë t'i argumentoni ligjërisht të gjitha ato që u thanë. Do ta kisha vlerësuar shumë që këtë debatin kështu tendencioz, si hetusi ta evitohet. Ne jemi organ shumë demokratik.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: E mbylla, do të jem shumë i qetë.

Z. E. Çefa: Po jua jap fjalën!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Fjala ime është e njëjta që kam dhënë te Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në regjistrimin e partive politike merret vendimi i gjykatës, numri i llogarisë së personit përgjegjës, kërkesa, betimi e të gjitha me rradhë. Organizimi brendshëm i partisë është vetëm për partinë politike dhe për gjykatën kur lind nevoja për ndryshimet e nevojshme. Këtë shkresën që keni, që përmendi zoti Nuri, që lidhet me faktin e regjistrimit të Partisë Demokratike do të shikosh se kryetari është ndryshuar vetëm kur është ndryshuar emri i kryetarit. Ndryshimi në Regjistrin e Partive Politike bëhen vetëm kur ndryshon emri i kryetarit. Në këtë rast nuk ka ndryshuar emri i kryetarit, është i njëjti, e para. E dyta, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka parë dokumentacionin nga ana formale, siç i takon ta shohë. E ka vlerësuar drejtë. Vendimi i gjykatës është i drejtë. Vendim pezullimi për aktivitetin e partisë politike nuk ka. Jemi në kushtet normale të kryerjes së aktivitetit politik. Siç kanë hapur disa deputetë, ose zoti Bardhi proces gjyqësor, ka hapur dhe zonja Edith Harxhi në mos gaboj, ka disa vjet që është në gjyq dhe unë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

përfaqësoj përsëri partinë politike. Jemi në të njëjtën situatë, dmth nuk mund të vish me argumentin se zonja Harxhi është në gjyq prej dy vjetësh dhe mos të regjistrojmë një parti politike. Këto janë argumente që mund t'i lexojë vetëm gjykata, jo një organ administrativ. Gjykata kur e sheh të nevojshme dhe kur e sheh në kushte të mbështetura në ligj merr dhe masat përkatëse që ka dhe Kodi i Procedurës Civile. Në këtë rast ne nuk kemi asnjë vendim nga Gjykata e Tiranës të cilët të pezullojnë aktivitetin e partisë politike, Partia Demokratike e Shqipërisë. Në momentin që do të fitohen këto gjyqet dhe do të bëhen pasqyrimet përkatëse atëherë patjetër që do të ketë reflektim nga ana e Partisë Demokratike, sepse nuk mund të vazhdojë aktivitetin. Por deri në atë moment besoj se nuk jemi në kushtet për t'u marrë me diskutime të tilla. Kjo është fjala ime. Zotëria që pretendon që është kryetar me referendum i një partie imagjinare nuk ka denjuar as të kërkojë në gjykatë regjistrimin e tij si kryetar. Po të shikoni vendimin që i referohen këta, marsit 2023, thotë: "Komisioni i Rithemelimit...", seç kanë një term, nuk ka kryetar Sali Berisha aty fare. Dmth, Sali Berisha e ndjen aq shumë veten kryetar sa as në gjykatë nuk ka tentuar të shkojë. Ai vendimi që i referohen këta është Komisioni i Përhershëm i Rithemelimit, seç kanë një term të tillë, por nuk ka atje emër kryetari. Ndaj këto janë diskutime vetëm për të penguar aktivitetin partiak të Partisë Demokratike. Kjo kohë që po e shfrytëzojmë këtu, është një debat i kryer disa herë tanimë dhe nuk besoj se do të ketë ndryshime në mënyrën e arsytimit të këtyre kërkesave, faleminderit.

Z. E. Çefa: Faleminderit zoti Sefa! Po Zoti Nuri.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Kisha dy pyetje të paktën për përfaqësuesin e zotit Basha, zotin Sefa. Është e vërtetë që në vendimin e Kolegjit Zgjedhor me numër 5

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

të muajit mars 2023 është pranuar nga ana juaj publikisht në seancë, në Kolegj se zoti Basha kishte dhënë dorëheqjen nga Partia Demokratike si kryetar i saj? Nëse doni të përgjigjeni? Në mos mund të vazhdoj me pyetjen? Nëse zoti Basha... e marrim të mirëqenë që zoti Basha e ka dhënë dorëheqjen në atë kohë. Rizgjedhja e zotit Basha që ju pretendoni në kuptimin tuaj të ligjit qoftë për partitë politike, apo dhe të Kodit Zgjedhor apo më gjërë, nuk e ka të detyrueshme të regjistrohet? Të lutem qëndrimin tuaj?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Për sa kohë ligji detyron vetëm kur ka ndryshime të titullarit të institucionit, vetëm atëherë është i detyrueshëm ndryshimi. Por meqë jemi si palë, pa merak kur të vijë ora do të çohen në gjykatë të gjitha dokumentet e nevojshme.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Pyetja e fundit. Përpara gjashtë muajsh përse nuk u regjistrua Partia Demokratike, sipas jush, me emrin e zotit Basha, përderisa te fleta e regjistrimit të partive politik ai emër ishte edhe atëherë, ai emër është edhe sot.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Organizimi i brendshëm i partisë politike nuk është as në dorë të zotit Berisha, as të rithemelimit, as të Komisionerit Publik, as të organeve të tjera të administratës shtetërore, por është në dorë të vetë organeve të Partisë Demokratike. Mënyrat se si përfaqësohen organet e Partisë Demokratike e përcakton statuti. Në atë rast ishte statuti që vendosi dhe me të drejtë ky organ, KAS-i, vlerësoi se organizimi i brendshëm i partisë politike, është vetëm i partisë politike. Si rrjedhojë e kësaj, në bazë dhe të dokumenteve të paraqitura nga Partia Demokratike vlerësoi se organizimi i brendshëm ka detyrimin ligjor që organet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

publike, të respektojnë organizimin e brendshëm dhe sipas ligjit “Për Partitë Politike”.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Më lindi dhe një pyetje e fundit nga përgjigjia juaj që sapo dhatë. Kjo do të thotë që për t’ju kthyer dokumenteve që ne paraqitëm dhe që janë të Partisë Demokratike dhe të këshillit kombëtar me vulë të sekretarisë së gjykatës. Ju keni qëndrimin se këto dokumente nuk i përkasin organizimit të brendshëm të Partisë Demokratike? I referohem mbledhjes së këshillit kombëtar nga Sekretari i Përgjithshëm zoti Bardhi që ju njihni?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo, nuk janë të Partisë Demokratike. Partia Demokratike ka organe, nuk është organ monokratik. Ka organe, ka kryesi, ka këshill kombëtar...

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Po pikërisht këshilli kombëtar po e jep.


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po pra, por ka organe, nuk është parti monokratike që një organ i bën të gjitha. Nuk është ashtu.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Këshillit kombëtar po i referohesha. Nëse, nuk e di a e keni një kopje të këtij vendimi? Nëse ju duhet ose...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ç’vendim?! Është kërkesë...

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Jo, kemi dhe vendimin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Çfarë vendimi?


Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Kemi dhe vendimin. Urdhëro, procesverbal i mbledhjes së këshillit kombëtar.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Çfarë vendimi? Kur të fitoni gjyqin, meqenëse jeni dashamirës dhe do të bëheni bashkë për të krijuar një strategji mbrojtje shumë cilësore, kur ta fitoni ejani. Por fitojeni njëherë, sepse është praktikë, nëse hap gjyq...

Z. E. Çefa: Zoti Rusmali ka një pyetje më pas edhe kolegët e tjerë.

Z. I. Rusmali: Unë e kam për zotin Nuri. Vendimi nr. 5 i Kolegjit Zgjedhor që ju ju referuat dhe që është detyrues për të gjithë ne, për ne këtu dhe për ju atje ka përcaktuar qartë, që ju si palë legjitimoheni të kërkonit përpara KAS-it, pastaj edhe përpara Kolegjit, që ju të regjistroheshi për shkaqe ligjore që ju i mendoni se ju japin të drejtën e regjistrimit, por nuk legjitimoheni të kërkonit që pala tjetër të mos regjistrohet. Ajo është e tyre. Ju duhet të kërkonit të regjistroheshi. Tani ju thatë me shumë të drejtë nga ai vendim ka pasur zhvillime politike brenda këtyre grupimeve dhe na i përmendët me pika. Unë do të doja nëse e keni mundësinë, nëse nuk e keni nuk ka problem, më thoni si ndikojnë këto akte që kanë ndodhur te pala tjetër, tek e drejta juaj për tu regjistruar? Pra, fakti që Gazmend Bardhi është prishur me Lulëzim Bashën ju'a jep juve të drejtën që ju të jeni Partia Demokratike? Këtë lidhje do të doja të dija unë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Po ju kuptova drejt. Në lidhje me legjitimimin mendova se e kishim ezauruar seancën e kaluar kur ne parashtruan...

Z. I. Rusmali: Ju lutem ju kuptova, citova vendimin e Kolegjit Zgjedhor. Nuk diskutova ju keni të drejtë të merrni pjesë... e kemi mbyllur. Kolegji Zgjedhor e ka përcaktuar legjitimimin tuaj. Ka thënë ju legjitimoheni vetëm për kaq, për të kontestuar mosregjistrimin nga Komisioneri, por jo për të kërkuar që mos të regjistrohet...

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Është e vërtetë ka vetëm një Parti Demokratike dhe ne prekemi automatikisht nga regjistrimi i Partisë Demokratike me zotën Basha të kryer nga Komisioneri Celibashi. Në këtë vendim që ne po kontestojmë për shkak se të dy vendimet janë bashkë, janë bashkuar të dy kërkesat tona dhe kanë dalë në një vendim të Komisionerit. Ne, në vlerësimin tim, legjitimohemi ta kërkojmë çregjistrimin e palës tjetër, sepse nuk mund të regjistrohen dy Parti Demokratike me dy kryetarë të ndryshëm, ose do të regjistrohet njëra, ose do të regjistrohet tjetra. Argumentet që ne dhamë për regjistrimin tonë si subjekt i kemi parashtruar dhe herën e kaluar, janë në dosje dhe nuk doja të zgjatesha përtej këtyre. Por, gjithashtu nuk mundet kurrësesi, të mos vë në evidencë argumentet se pse nuk duhet të regjistrohet pala tjetër, sepse vetëm një do të regjistrohet në këto zgjedhje. Ose njëra ose tjetra, ose eventualisht asnjëra, nëse asnjëra nuk i plotëson në vlerësimin dhe gjykimin tuaj kushtet dhe kriteret ligjore.

Z. E. Çefa: Po zoti Sefa.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Provat e paraqitura nga ana juaj kanë provueshmërinë sipas ligjit, kanë efekt të plotë ligjor do të merren si prova nga ana e KAS-it?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Nuk e kuptoj përse mos ta kenë provueshmërinë dhe nuk shoh asnjë lloj pengese që të mos e kenë. Pastaj do ta çmojë KAS-i nëse do të administrohen si prova apo jo në shqyrtimin në themel të çështjeve.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Për partinë e zotit Sali Berisha, zoti Gazmend Bardhi është Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Këto janë pyetje politike që nuk lidhen me kontekstin.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo të lutem, e pyeta a ka ligjshmëri prova, më tha “po, janë të organit”. Tani po ju pyes, zoti Bardhi, për zotin Sali Berisha është Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Jo duhet një korigjim i vogël...

Z. E. Çefa: Cilësinë e provës nuk e jep fakti nëse e njih Sali Berisha sekretarin e përgjithshëm, apo jo?! Ja jep tjetër kush.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: I nderuar, ka sjellë një provë dhe thotë, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, zoti Gazmend Bardhi... ka sjellë këtë provë! E

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

paraqet në formën e provës. “Ne si parti..”, thotë, “..me drejtues Sali Berishën, themi se kjo provë ka efektin e plotë ligjor”. Tani zotëria e njeh organin e sekretarit të përgjithshëm si institucion?

Z. E. Çefa: Nuk ka rëndësi e njeh apo nuk e njeh, kjo nuk e ndryshon vlerën e asaj prove.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Këta vijnë në KAS dhe thonë këta nuk janë partia, jemi ne apo jo?

Z. E. Çefa: Dakord, zoti Nuri ju lutem jepni përgjigje shkurtimisht për avokatin.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Këta vijnë në KAS dhe thonë këta nuk janë partia, pastaj marrin dokumentet tona dhe thonë këto janë dokumentet ligjore. Nuk bën sens.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Ja po jua shpjegoj. Sens logjikë, bën patjetër, më lejoni t’jua shpjegoj vetëm me një minutë. Për sa i përket pyetjes suaj të fundit nëse njohim apo nuk e njohim... kjo nuk më përket mua, sepse unë jam përfaqësues patjetër, por nuk e kam tagrin që të shprehem dhe as të njoh kushdo qoftë personi. I takon vendimmarrjeve të tjera dhe aq më tepër vendimmarrjeve politike. Kurse ne këto dokumente i kemi sjellë dhe për provueshmërinë e tyre ligjore unë u shpreha dhe do të citoj në mënyrë korrekte, që do të jetë KAS-i ai që do të vlerësojë a kanë vlera ligjore apo provueshmërie. Për sa i përket faktit që përse i kemi sjellë ne këto dokumente? Ne i kemi sjellë këto dokumente pikërisht për t’ia kundërvënë atyre që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

keni sjellë ju! Ju keni thënë që është Lulzim Basha kryetar i rizgjedhur dhe ja ku është... ose ai është kryetar i Partisë Demokratike, ndërkohë që ne kemi letrat.. dhe unë e shpreha qartë, që sekretari i përgjithshëm që ju njihni. Letrat e sekretarit të përgjithshëm që deri dje ju e njihnit dhe ja ku janë shkresat e atij që e kundërshton këtë gjë. Nuk janë vetëm shkresat e sekretarit të përgjithshëm tuaj por është edhe e këshillit kombëtar që ju herë pas here e keni mbledhur gjatë këtyre muajve dhe kur ka marrë vendime që ju kanë shkuar për shtat juve ju ka leverdisur...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Mbledhur fizikisht...

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Se si është mbledhur kjo pak rëndësi ka për mua. Unë këtë e paraqes për t'u kundërvënë dhe për të nxjerrë në pah kontradiktat tuaja. Vetë rizgjedhja e zotit Basha është e kontestuar nga pala që deri dje ishit bashkë dhe kryenit të gjitha vendimmarrjet e këshillit kombëtar...

Z. E. Çefa: Qartë zoti Nuri, ju lutem limitohuni tek përgjigjet specifike pa komente. Tani unë kam një pyetje. Zoti Sefa jo opinione, argument juridik. Kam një pyetje për secilin prej jush. Filloj nga zoti Nuri përpara. Përfaqësuesi i palës së interesuar pohoi në fjalën e tij që i përfaqësuari nga ju, pra i prezumuari krytar i Partisë Demokratike zoti Sali Berisha nuk ka parqitur këkesë për regjistrim në Regjistrin e Partive Politike si kryetar i zgjedhur i partisë. Është i vërtetë ky fakt apo jo?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Në dijeninë time është paraqitur kërkesa dhe më pas ka rrjedhur vendimi i muajit mars 2022. Është paraqitur kërkesa për regjistrimin e Komisionit të Rithemelimit në atë kohë, edhe pse unë nuk kam qenë pjesë e atij

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

procesi, nuk e kam ndjekur dokumentacionin, sepse ai organ kolegjal u vendos nga Kuvendi Kombëtar i dhjetorit 2021 për të përfaqësuar Partinë Demokratike në atë kohë. Më pas pasi doli vendimi i marsit 2022, organet kolegjiale të asaj kohe që drejtonin Partinë Demokratike morën vendimin për ta zgjedhur dhe për ta mandatuar zotin Berisha nëpërmjet votës së drejtpërdrejtë të anëtarëve dhe të Partisë Demokratike me referendum, që ka ndodhur disa javë më pas. Për t'ju përgjigjur pyetjes suaj, nuk jam në dijeni nëse është depozituar ndonjë akt tjetër përtej kësaj në gjykatë, sepse nuk jam marrë unë personalisht me këtë çështje dhe nuk kam informacion për momentin në lidhje me këtë pikë. Siç dihet çështja është në Gjykatën e Lartë...

Z. E. Çefa: Vendimi i cili është i pasqyruar dhe në shkresë, pra vendimi gjyqësor i cili u shfuqizua nga Gjykata e Apelit me çfarë kërkesë kishte të bënte?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Duhet t'i referohem atij për të qenë të saktë, nuk e kam këtu përpara që t'i referohem në mënyrë specifike.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kërkuesi ishte Komisioni i Rithemelimit në Partinë Demokratike.

Z. E. Çefa: Çfarë objekti kishte?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Regjistrimin e vendimit nr. 1, 2, 3, 4. Zoti Berisha me këto zgjedhjet e veta që është hamendësuar që do të zgjidhet kryetar, është zgjedhur kryetar nga prilli, nga fundi i prillit, në maj më falni, maj 2022.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. E. Çefa: Këtë sqarim të na e jepte më mirë zoti Nuri sepse ti nuk je...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Të lutem, meqenëse jam në brendësi edhe të asaj... dhe që nga maji i vitit 2022 nuk i është drejtuar një herë gjykatës për t'u regjistruar si kryetar i Partisë Demokratike.

Z. E. Çefa: Ndoshta pret që gjykata të regjistrojë më përpara ndryshimet e statutit dhe më pas të regjistrohet ai. Tani pyetja tjetër për ju. Po ju zgjedhjen e dytë të zotit Basha si kryetar të Partisë Demokratike e keni paraqitur kërkesë në gjykatë për ta regjistruar?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kur të jetë momenti i përshtatshëm do ta paraqesim. Nuk kemi asnjë detyrim...

Z. E. Çefa: Domethënë nuk keni paraqitur kërkesën?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Nuk kemi asnjë detyrim ligjor të paraqesim kërkesë për sa kohë që kryetari është i njëjtë.

Z. L. Braho: Mbase dhe zoti Berisha ka të njëjtin qëndrim. Ka qenë kryetar deri në vitin 2013 dhe nuk e sheh të arsyeshme të regjistrohet.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Sipas ekstraktit të marrë nga zoti Bardhi ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që me vendimin nr. 8861, dt. 12.08.2013,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur depozitimi i aktit të zgjedhjes së kryetarit të ri të Partisë Demokratike zotit Lulëzim Basha. Zgjedhjet e mbajtura në këtë parti në datën 22.07.2013. Kur të depozitohet zoti Berisha zgjedhjet e majit 2022 dhe t'ia pranojë gjykata do të dalë këtu më pas, që u ndryshua kryetari dhe u zgjedh ky i riu me zgjedhjet...

Z. L. Braho: Te kjo e gjykatës ju e pranoni që është Lulëzim Basha i zgjedhur në vitin 2021?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: 2013 dhe 2021 në vazhdim po.

Z. L. Braho: Është e 2021-shit aty.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kjo që lexova unë është e vitit 2013, e kemi regjistruar edhe në vitin 2013, sepse ligji thotë kur ndryshohet kryetari...


Z. L. Braho: Që nga viti 2013 nuk është regjistruar më Lulëzim Basha?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: E kemi regjistruar në vitin 2021.

Z. L. Braho: Këtë po them, pra e fundit është në vitin 2021. Ndërkohë që po ju këtu keni qenë që keni pranuar dorëheqjen e zotit Lulëzim Basha në vitin 2022.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. L. Braho: Tani aty nuk reflektohet zgjedhje tjetër?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po.

Z. L. Braho: Në vitin 2023, po KAS-i dhe Kolegji konfirmuan faktin që ishte zoti Enkeled Alibeaj kryetar i komanduar...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Sipas statutit të Partisë Demokratike dhe organizimit të brendshëm të Partisë Demokratike.

Z. L. Braho: Sipas atyre që ju thatë janë çështje të organizimit të brendshëm. Pra, atëherë vllente organizimi i brendshëm për palët e tretë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po patjetër që vllen!

Z. L. Braho: Por nëse vllen këtë herë, duhet të pranoni këtë vllimin e këshillit kombëtar pastaj, që është depozituar edhe në gjykatë apo jo?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Vllimimi që ne..., shkresa që sapo cituam.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Lexoni ligjin e partive politike ju lutem dhe referojuni!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. L. Braho: Zoti Sefa, e kam lexuar disa herë. Nuk po flasim për ligjin e partive politike. Ligji “Për Partitë Politike” thotë që efektet për palë të treta jepen pasi regjistrohen në gjykatë apo jo?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Të lutem neni 14 thotë: “Kërkesa për ndryshimin në regjistrin e partive politike, bëhet nga organi i partisë që ka kompetencë përfaqësimit e saj ndaj të tretëve...”. Kur të ndryshojë statuti i Partisë Demokratike dhe të dalin disa deputetë që mund ta përfaqësojnë Partinë Demokratike, atëherë me të drejtë mund t’ia pranojë edhe gjykata.

Z. L. Braho: Është sekretariati i këshillit dhe është këshilli që i ka autorizuar.


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kur të vërtetohet që është zgjedhur ai., se më kanë shkarkuar pa e ditur, se unë jam zgjedhur nga këshilli kombëtar, anëtar i sekretariatit por në letra del tjetërkush.

Z. L. Braho: Unë nuk e di kush është këshilli kombëtar tani se tjetër shoh në media e tjetër më del në letra, nuk po flasim për këtë.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kjo është çështje e organizimit të brendshëm, ju nuk e dini organizimin e brendshëm, kush ka qenë anëtar...

Z. L. Braho: Nuk e di, nuk kam informacion fare për organizimin e brendshëm të Partisë Demokratike.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Dispozitat e këtij ligji janë të vlefshme për ndryshime në regjistrimin e mëparshëm...

Z. L. Braho: Që domethënë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Çfarë thotë ligji?! Thotë që regjistrohet emri i kryetarit dhe statuti. Emri i kryetarit, kur të kemi nevojë që të ndryshojmë kryetarin, të zgjidhet një kryetar i ri, patjetër që do ta çojmë, sepse sjell efekte për përfaqësimin ndaj të tretëve.

Z. L. Braho: Për KQZ-në, Lulëzim Basha është i dorëhequr në vitin 2022.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Për KQZ-në, me vërtetim nga gjykata dhe me vërtetim nga Partia Demokratike e Shqipërisë, rezulton që zoti Lulëzim Basha është kryetar i Partisë Demokratike. KQZ-ja nuk ka se si ta dijë se si funksionon Partia Demokratike.

Z. L. Braho: Ju vetë keni pohuar që ka dhënë dorëheqjen!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Të lutem, KQZ-ja nuk ka nga ta dijë se si funksionon Partia Demokratike dhe kush janë organet Partisë Demokratike. KQZ-ja sheh anën formale të akteve, sheh vërtetimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, sheh dokumentacionin e plotësuar nga Partia Demokratike dhe vendos vetëm mbi ato... se çfarë ka dëshirë KQZ-ja të hetojë është diskutim tjetër!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. L. Braho: Indrit, për fat të mirë, ju jeni përfaqësues i përhershëm në KQZ i Partisë Demokratike dhe ke qenë edhe në zgjedhjet e 14 majit. Në zgjedhjet e 14 majit keni mbajtur qëndrim krejtësisht tjetër. Në kundërshtim me këto formalitete që po i pretendoni tani!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Me këtë?! Asnjëherë! Kam thënë është çështje e organizimit të brendshëm. Unë e kam sjell me shkresë në KQZ. Kam thënë në Partinë Demokratike në bazë të statutit drejtues aktual i Partisë Demokratike është zoti Enkelejd Alibeaj si kryetar i komanduar.

Z. L. Braho: Kishte vërtetim gjykatë zoti Enkelejd Alibeaj?


Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Sepse thashë që nuk mund të regjistrohet në Regjistrin e Partive Politike, kam thënë që atëherë, nuk mund të regjistrohet nënkryetari. Regjistrohet vetëm zgjedhja e kryetarit të ri. Zgjedhja e kryetarit të ri.

Z. L. Braho: Ju nuk e keni kryetarin e ri sot?!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: E kam si se kam, në 29 korrik, me vendim në mos gaboj nr. 3 të Komisionit Zgjedhor të Partisë Demokratike, është zgjedhur zoti Lulëzim Basha...

Z. L. Braho: Sipas Partisë Demokratike historiku i Enkelejd Alibeajt është fshirë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: ... me gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë vota! Zoti Enkelejd Alibeaj... komandimi nuk regjistrohet.

Z. L. Braho: Që nga viti 2022 deri tani në gusht të vitit 2023 është fshirë nga historiku i partisë.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Komandimi nuk regjistrohet.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Po dorëheqja regjistrohet?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Me anë të ligjit... nuk regjistrohet as dorëheqja. Me anë të ligjit të partive politike komandimi nuk regjistrohet. As dorëheqja nuk regjistrohet.

Z. E. Çefa: Atëherë, ju nuk e dini ose nuk e keni vendosur nëse do ta regjistroni kryetarin zotin Basha?! Vijimi i pyetjes sime, po ndryshime në statut a keni bërë këtë rradhë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po!

Z. E. Çefa: Po për këto, keni paraqitur kërkesë për t'i depozituar në gjykatë, se është detyrim ligjor ky.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ka ndonjë afat ligjor që më detyron?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. E. Çefa: Pyetja ishte: A keni paraqitur kërkesë në gjykatë deri në këtë moment. Deri në momentin që flasim a keni paraqitur kërkesë në gjykatë?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ka afat ligjor që më detyron?

Z. E. Çefa: Zoti Sefa, ju lutem se e drejtoj unë seancën!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Për çfarë i intereson hetimit tuaj?

Z. E. Çefa: Përgjigjuni pyetjes që ju bëra! Deri sot, keni depozituar kërkesë për regjistrimet në gjykatë të ndryshimeve në statutin e partisë suaj? Po, apo jo kaq!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Do të depozitohen në momentin që ne do e vlerësojmë...

Z. E. Çefa: Nuk janë depozituar!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kush tha?

Z. E. Çefa: Nuk janë depozituar pra!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kur ta mendojmë ne më të përshtatshme!

Z. E. Çefa: Ju lutem shumë jo, ju tërheq vemendjen të jeni serioz.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jam shumë serioz.

Z. E. Çefa: Ju lutem mua nëse më pohoni diçka mos e mohoni direkt mbrapa. Pyetja është për efekt procesverbali. Po apo jo?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Këtu KAS-i nuk merret me mënyrat, modalitetet të përcaktuara nga ligji “Për Partitë Politike”.

Z. E. Çefa: Ju vetëm serioz nuk jeni, më vjen shumë keq që po e dërgoni debatin në këtë rrjedhë. Vetëm serioz nuk jeni.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Unë jam palë e interesuar, se çfarë bëj unë...
(pa mikrofon nuk dëgjohet)

Z. E. Çefa: Pyetja tjetër që kisha për të dy, nëse mund të përgigjeni. Ju pretendoni të dy që keni struktura paralele dhe drejtoni Partinë Demokratike: këshill kombëtar, me vendime, me statut të ndryshuar, i paregjistruar. Tani efektet juridik të secilit prej këtyre dy forumeve për efekt të KAS-it, a mund të na i thoni sipas jush? Çfarë efektesh juridike kanë sipas jush, këto situata paralele?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Deri në regjistrimin e statutit të ri, ju zotëri, ne e kemi statutin të përcaktuar qartë. Për rregullin e brendshëm hyn në fuqi menjëherë. Ne e kemi të përcaktuar. Nëse statuti i ri po ta shihni dhe nëse doni mund t’jua paraqesim një kopje, nëse e shihni që ka vend....

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. E. Çefa: Kur ta regjistroni në gjykatë të na e sillni kopjen.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Nëse ka boshllëk përfaqësimi, mund ta ngrini si pretendim. Ju nuk mund të vini këtu të bëni gjyqin e Partisë Demokratike. Ju lutem jepini përgjigje kërkesës...

Z. E. Çefa: Keni ardhur ju more zotëri tek ne.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo unë nuk kam ardhur fare. Mua më kanë hedhur në gjyq.

Z. E. Çefa: Keni ardhur ju tek ne, na kërkoni të ndajmë një mosmarrëveshje!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo unë nuk kam mosmarrëveshje fare! Unë jam regjistruar si subjekt zgjedhor. Zotëria...

Z. E. Çefa: Pretendon tjetri që je regjistruar në kundërshtim me ligjin.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Zotëria që kërkon të drejtën të vijë në gjykatë...

Z. E. Çefa: E mora përgjigjen faleminderit! Zoti Nuri nëse keni përgjigje për pyetjen time. Besoj e kuptuat, më fal, efektet juridike që kanë secili sipas opinionit tuaj sigurisht. Secila nga këto situata, nga këto vendime të forumeve të partisë?


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Ne i kemi vendimet të depozituara që nga Kuvendi Kombëtar i dhjetorit të vitit 2021. Pra, kemi vendime që janë njohur nga Gjykata e Shkallës së Parë. E njohim faktin se aktualisht ka një problematikë me Regjistrin e Partive Politike dhe ai është i papërditësuar edhe për shkak të situatës që ndodhi me vendimin e Gjykatës së Apelit, që për hir të së drejtës nuk e ka zgjidhur themelin e konfliktit dhe nuk është shprehur aspak se kujt i takon Partia Demokratike. Por, apeli duke gjetur një cen procedural ndër të tjera, ka vendosur që ta prishë vendimin e shkallës së parë, sepse paska pasur sipas apelit, shkelje të barazisë apo paanshmërisë së trupit gjykues të shkallës së parë dhe e ka kthyer për gjykim. Pra, Gjykata e Apelit Tiranë, nuk ka vendosur se kujt i përket Partia Demokratike dhe aq më pak se kjo nuk i përket zotit Berisha, përkundrazi. Ne, brenda pesë ditëve nga e drejta për të paraqitur rekurs, kemi paraqitur rekurs në dijeninë time, në Gjykatën e Lartë në datën 15 maj dhe jemi ende në pritje të Gjykatës së Lartë për ta ezauruar këtë proces. Ne mendojmë se Regjistri i Partive Politike nuk është i përditësuar, në këto kushte duhet të bazohemi në realitetin politik dhe realiteti politik, sikundër doli dhe nga zgjedhjet e fundit vendore dhe realiteti aktual dhe faktik, pra ajo që dihet në bazë të nenit 139, pika 1 e Kodit Zgjedhor, fakte të njohura botërisht. Është zoti Berisha ai që njihet nga shumica e votuesve të Partisë Demokratike si kryetar, por edhe e zgjedhësve shqiptarë, si kryetar i Partisë Demokratike. Nga ana tjetër sikundër edhe e pamë, edhe pala që pretendon se Partinë Demokratike e drejton zoti Basha nuk i ka të përditësuarat të dhënat në regjistrin e Partive Politike. Është shumë logjike. Po ti kishin të përditësuarat, e po të ishin të sakta ato të dhëna, në mars të vitit 2023, para 6 muajsh, zoti Basha do të ishte regjistruar si kryetar i Partisë Demokratike pa asnjë lloj dyshimi, por nuk ndodhi kështu. Nuk u regjistrua dot zoti Basha por nënkryetari. Nëse në atë kohë palës kundërshtare që kam unë këtu sot i leverdiste të shprehej se

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

realiteti politik duhej marrë në konsideratë, pra duhej marrë në konsideratë organizimi i brendshëm i Partisë Demokratike, sot fatkeqësisht e konstatojmë se kjo gjë nuk i leverdis. Nuk dëshiron të marrë parasysh vendimarrjen e brendshme të paktën të asaj pjese të Partisë Demokratike ku kanë aderuar deri pak kohë më parë edhe sekretari i përgjithshëm që ka marrë këto vendime nga Këshilli Kombëtar i 27 korrikut 2023. Pra, të dy palët jemi në këtë situatë ku Regjistri i Partive Politike nuk pasqyron realitetin. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Atëherë kolegë e keni fjalën.


Z. I. Rusmali: Kam një pyetje për administratën. Përveç dy kërkesave të palëve që janë këtu prezent, në emër të Partisë Demokratike ka pasur ndonjë kërkesë tjetër për regjistrim?

Z. Y Merkaj: Jo nuk ka pasur.

Z. E. Çefa: Pyetje të tjera? Nuk ka! Atëherë zoti Merkaj për procedurë do j'ua jap edhe ju fjalën lidhur me çështjen. Pra, opinionin dhe qëndrimin tuaj zyrtar. Konsiderojeni edhe si konkluzion meqenësë tashmë e ezauruam.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur dy kërkesa për regjistrimin e të njejtit subjekt zgjedhor. Njëra nga zoti Lulëzim Basha dhe tjetra nga zoti Sali Berisha nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Komisioneri i ka marrë në shqyrtim të dy kërkesat në një procedurë administrative dhe është bazuar në nenin 64 të Kodit Zgjedhor ku citohet se për të regjistruar një parti politike si subjekt

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*


zgjedhor, duhet të paraqesë: vërtetimin që partia është e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët. Emrin zyrtar, shkronjat nistore, adresën e partisë, specimenin e vulës, emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit, emrin mbiemrin e personit përgjegjës për komunikimin në KQZ, si dhe deklaratën solemne me shkrim të kryetarit. Duke parë dokumentet e të dy palëve Komisioneri ka vlerësuar se Partia Demokratike, ose kërkesa e zotit Lulëzim Basha, plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 64, të Kodit Zgjedhor. Në lidhje me kërkesën tjetër ose me debatin që është shtruar midis të dy palëve, Komisioneri ka vendosur se për KQZ-në përmbajtja e vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me çështjen se kush është kryetari i një partie politike, për KQZ-në është fakt juridik, të cilin KQZ-ja, në asnjë rrethanë dhe pa asnjë shkak nuk mund ta vendosë në diskutim. Në këto kushte Komisioneri ka vendosur se kërkesa e paraqitur nga zoti Lulëzim Basha plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 64 dhe ka vendosur regjistrimin e Partisë Demokratike, me kryetar zotin Lulëzim Basha. Ju faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Po, zoti Sefa.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Një pyetje për administratën. Zoti Merkaj siç jeni në dijeni, ju keni hapur një portal për regjistrimin e partive politike dhe ju komplimentoj për këtë. Gjithë procedura e regjistrimit dhe komunikimi me KQZ-në bëhet nëpërmjet këtij portali. Është e vërtetë kjo?

Z. Y Merkaj: KQZ-ja për t'i ardhur në ndihmë edhe administratës por edhe partive politike ka hapur një portal ku mund të regjistrohen subjektet zgjedhore. Kjo nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

anashkalojnë faktin se një parti politike mund ta sjellë dhe fizikisht hardcopy në protokollin e KQZ-së. Në rast se një subjekt zgjedhor dorëzon hardcopy dhe nuk regjistrohet në portal atëherë është detyrim i administratës së KQZ-së ta regjistrojë me dokumentat që ka në hardcopy, ta hedhë në portal. Por, në asnjë rast nuk e përjashton një parti politike nga zgjedhjet nëse nuk e sjell në portal.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ju faleminderit për përgjigjen ezauruese por kisha një pyetje tjetër. Partia Demokratike është regjistruar në këtë portal?

Z. Y Merkaj: Nga pesë ose gjashtë parti politike që janë regjistruar si subjekte zgjedhore në zgjedhjet e datës 24 shtator, dy parti politike janë regjistruar në portal. Partia Socialiste dhe Partia Demokratike. Partitë e tjera i kanë sjellë hardcopy siç e thashë dhe janë hedhur nga administrata e KQZ-së.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Po, pyetja tjetër. Ndonjë subjekt tjetër imagjinar që pretendon se është Partia Demokratik ka bërë kërkesë për tu regjistruar?


Z. Y Merkaj: Vetëm 2 subjekte janë regjistruar në portal, PS dhe PD.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Pyetje të tjera? Po zoti Nuri.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Faleminderit! Një pyetje dhe unë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për sekretarin e përgjithshëm. Nisur nga parashtrimet tuaja,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

nga konkluzionet nëse mund ta konsiderojmë kështu, u shprehët se jeni të detyruar t'i referoheni Regjistrin të Partive Politike dhe emrit që figuron aty për kryetarin e partive, nëse ju citova saktë. Pyetja është e thjeshtë, përse në zgjedhjet e kaluara dhe në Rrogozhinë ku pati zgjedhje gjithashtu, Partia Demokratike nuk u regjistrua me zotin Basha, i cili figuronte aty në Regjistrin e Partive Politike, faleminderit.

Z. Y. Merkaç: Mendoj se kjo pyetje nuk është për administratën. Ne jemi në një proces. Kemi në shqyrtim vendimin nr. 745 të Komisionerit, për këtë vendim besoj se u përgjigja.

Z. E. Çefa: Zoti Rusmali e ka fjalën.

Z. I. Rusmali: Për zotin Nuri, ne pak më përpara trajtuam një çështje tjetër që ka lidhje me formimin e komisionit të KZAZ-së e më poshtë. Ka një vendim të Komisionerit nr. 722, që përcakton që Partisë së Lirisë i takojnë dy komisionerë dhe Partisë Demokratike i takon një komisioner. Kjo ka ndodhur para se të bëhej procesi i regjistrimit të partive. Ju si e keni ndjerë veten në raport me këtë vendim? E keni konsideruar që po ju jepej ju komisioneri apo po ju jepej atyre?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Të them të drejtën nuk e kam ndjekur fare si proces. Nuk kam asnjë lloj dijenie dhe nuk e kam ndjekur fare as si proces ankimor. Madje dje në mos gaboj ju më pyetët nëse kisha autorizim për të përfaqësuar çështjen që u gjykua... nuk e kam ndjekur fare dhe nuk kam asnjë lloj dijenie, kështu që nuk mund të shprehem sepse kjo është dhe e një natyre deri diku dhe politike. Nuk mund të shprehem, sepse nuk kam as tagër që të shprehem lidhur me këtë çështje.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. I. Rusmali: Administrata KZAZ-ja është plotësuar me anëtarë?

Z. Y. Merkaj: Po është plotësuar.

Z. I. Rusmali: Partia Demokratike që ka dhënë anëtarin cila është?

Z. Y. Merkaj: Sipas vendimit të Komisionerit nr. 722..

Z. I. Rusmali: Cila parti?

Z. Y. Merkaj: Partia Demokratike me kryetar Lulëzim Bashën.


Z. I. Rusmali: Ata kanë dhënë, ndërkohë që Partia Demokratike me kryetar Sali Berishën nuk e ka kundërshtuar emërimin.

Z. Y. Merkaj: Jo.

Z. E. Çefa: Pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka, atëherë do të kalojmë në konkluzione. Zoti Nuri e keni ju fjalën dhe më pas zoti Sefa.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Faleminderit! Pa ju marrë më tepër kohë, kërkojmë që t'i qëndrojmë patjetër kërkesës sonë duke e bazuar atë në ligj dhe në prova, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

Z. E. Çefa: Faleminderit! Zoti Sefa.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Rrëzimin e kërkesës së subjektit imagjinar, pasi nuk bazohet në prova, në ligj edhe në faktet e pohuara publikisht gjatë kësaj seance, faleminderit.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Rrëzimin e kërkesës ankimore të paraqitur nga zoti Franci Nuri!

Z. E. Çefa: Dakord, ju faleminderit! KAS do të tërhiqet për të diskutuar dhe për të vendosur mbi çështjen. Kolegë sa kohë mund të na duhet? Atëherë do të takohemi këtu në orën 13:30. Në rast se do të kemi nevojë për më shumë kohë do ju njoftojmë paraprakisht, faleminderit!

Rifillon seanca

Ora, 13:32

Z. E. Çefa: Riçelim seancën për shpalljen e vendimit. KAS pasi u tërhoq në dhomë këshillimi dhe diskutoi çështjen në tërësi, me shumicë votash vendosi:

- Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 94, datë 5.09.2023.
- Lënien në fuqi të vendimit nr. 745, datë 4.09.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.07.09.2023*

- Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë brenda pesë ditëve.
Me kaq seanca deklarohet e mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 182

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

